

LIGJ
Nr. 146/2015

PËR PUNËKËRKUESIT

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt rregullimin e procesit të regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit, përshtatjen e kërkesës/ofertës për punë dhe kualifikimit profesional, kontrollin e sigurisë dhe shëndetit në punë, si edhe pagesën për vendin e punës, që ofrohet në këto zyra.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i ligjit është ofrimi i mundësive për punësim dhe kualifikim për punëkërkuesit, në mënyrë të veçantë për përfituesit e mbështetjes me të ardhura.

Neni 3
Përkufizime

Në qoftë se në këtë ligj nuk parashikohet ndryshe, përkufizimet e bëra në ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim dhe në këtë ligj.

Neni 4
Regjistrimi dhe çregjistrimi i punëkërkuesve të papunë

1. Zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron çdo person që është në moshë për punë, që është i aftë dhe i gatshëm për punë, i cili deklaron se nuk është në marrëdhënie pune apo i vetëpunësuar, dhe paraqitet, personalisht, në zyrën e punësimit, me qëllim që të kërkojë punë.

2. Zyra e punësimit bën verifikimet në organet tatimore, për personin, në lidhje me deklarin e të punësuarve apo të vetëpunësuarve, dhe vendos për dhënien ose jo të statusit të punëkërkuesit, brenda një muaji kalendarik nga data e paraqitjes.

3. Punëkërkuesi i regjistruar duhet të paraqitet çdo muaj në zyrën e punësimit, apo sa herë i kërkohet një gjë e tillë prej saj.

4. Punëkërkuesi duhet të deklarojë përpjekjet individuale të tij për të gjetur një punë në tregun e punës. Ai është i detyruar të deklarojë në zyrën përkatëse të punësimit, çdo muaj, aplikimet për punë që ai ka bërë individualisht. Zyra e punësimit duhet të bëjë verifikimet përkatëse për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga punëkërkuesi. Në rast mospërputhjeje të tij me verifikimin, zyra përkatëse e punësimit e thërret dhe e riinterviston punëkërkuesin. Pas intervistës, zyra përkatëse e punësimit merr vendim për heqjen ose jo të statusit të punëkërkuesit.

5. Punëkërkuesve, të cilët paraqiten në zyrën e punësimit për regjistrim, pas intervistimit dhe vlerësimit të karakteristikave profesionale e individuale, bazuar në vendet e lira që disponohen, u ofrohen

mundësi pune të përshtatshme. Refuzimi i ofertës së punës së përshtatshme, qoftë edhe një herë, çon në refuzimin e statusit të punëkërkuës dhe mospajisjen e tij me vërtetimin përkatës.

6. Heqja ose refuzimi i statusit të punëkërkuës kryhet nëse oferta e punës apo programet e tjera të përshtatshme, që ofrohen, kundërshtohen, refuzohen apo nuk pranohen, si gjatë intervistimit të parë, ashtu edhe në takimet e radhës, në vijimësi, kur punëkërkuësi:

- a) refuzon një vend pune të përshtatshëm, qoftë edhe një herë të vetme;
- b) nuk kërkon më punë dhe e deklaron një gjë të tillë;
- c) refuzon pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit apo programe të tjera punësimi;
- ç) refuzon pjesëmarrjen në formimin profesional falas, i cili vlerësohet se ndihmon integrimin e tij në tregun e punës;
- d) ndërmjetësohet në punë;
- dh) ka gjetur vetë punë;
- e) nuk paraqitet në zyrën e punësimit një herë në muaj apo sa herë i kërkohet një gjë e tillë;
- ë) konstatohet se ka bërë një deklaratë false dhe kjo konsiderohet vepër penale.

7. Kundërshtimi, mospranimi apo refuzimi i vendeve të punës dhe i programeve të punësimit të ofruara konfirmohen nga punëkërkuësi, me nënshkrimin e tij. Në rast se punëkërkuësi refuzon nënshkrimin, specialisti i shërbimeve të punësimit vendos shënimin: “Punëkërkuësi refuzon të nënshkruajë”.

8. E drejta për riaplikim për statusin e punëkërkuës, të gjithë personave që nënshkruajnë ose refuzojnë nënshkrimin e deklaratës për refuzimin/mospranimin e vendit të lirë të punës, u lind pas një periudhe kohore 3-mujore.

9. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nxjerr udhëzimin për procedurën që do të ndiqet nga zyra e punës, sipas parashikimeve të këtij neni.

Neni 5

Kategorizimi i punëkërkuës

Punëkërkuësit, në kuptim të këtij ligji, kategori-zohen në këto nëngrupe:

1. “Punëkërkuës që përfitojnë ndihmë ekono-mike”. Këta janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e ndihmës ekonomike. Ata janë të detyruar të paraqiten në zyrën e punësimit çdo muaj, për të kërkuar punë, apo sa herë që u kërkohet një gjë e tillë. Në rast mosparaqitjeje dhe në rast refuzimi të një punësimi të përshtatshëm apo kualifikimi profesional, sipas nenit 4, të këtij ligji, ata hiqen nga lista e punëkërkuësve. Gjatë periudhës së ndjekjes së kualifikimit profesional, punëkërkuësi vazhdon të përfitojë ndihmën ekonomike.

2. “Punëkërkuës që përfitojnë pagesë papunësie”. Këta janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e të ardhurës nga papunësia, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ata janë të detyruar të paraqiten çdo muaj në zyrën e punësimit, për të kërkuar punë, apo sa herë që u kërkohet një gjë e tillë. Në rast mosparaqitjeje dhe në rast refuzimi të një punësimi të përshtatshëm apo kualifikimi profesional, sipas nenit 4, të këtij ligji, hiqen nga lista e punëkërkuësve. Gjatë periudhës së ndjekjes së kualifikimit profesional, punëkërkuësi vazhdon të përfitojë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

3. “Punëkërkuës të tjerë”. Këta janë persona, të cilët nuk përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura. Ata janë të detyruar të paraqiten çdo muaj pranë zyrës së punësimit, për të kërkuar punë. Në rast mosparaqitjeje dhe në rast refuzimi të një punësimi të përshtatshëm apo kualifikimi profesional, sipas nenit 4, të këtij ligji, hiqen nga lista e punëkërkuësve.

Neni 6

Heqja e statusit të punëkërkuës

Zyra e punësimit, pas heqjes së statusit të punëkërkuesit apo pas punësimit të tij, njofton menjëherë institucionin përgjegjës për ndihmën ekonomike, për marrjen e masave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

Neni 7

Sanksionet

1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ndjek dhe garanton zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

2. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ato nuk përbëjnë vepër penale, vendosen sanksionet e përcaktuara në shkronjën “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar.

3. Procedurat e ankimit ndaj sanksioneve të vendosura nga inspektori i punës janë sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar.

Neni 8

Aktet nënligjore

Ngarkohet Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e procedurës, sipas pikës 9, të nenit 4, të këtij ligji, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9398, datë 7.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani